Për letrat me vlerë, për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke ju referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë.

**Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare**

Mjetet financiare, me përjashtim të atyre klasifikuar si "Të mbajtura për tregtim", vlerësohen në çdo datë bilanci nëse kanë pësuar rënie në vlerë apo kanë humbur aftësinë shlyerse. Mjetet financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të mjetit financiar, janë ndikuar rrjedhat e ardhëshme të parave që pritet të merren nga investimi. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, përcaktohet shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë, duke u bazuar në vlerën neto aktuale të rrjedhjes së ardhshme të parasë që pritet të merret, dhe diferenca midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës kontabël njihet si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e rekuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të rekuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke pëfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjione për rënien në vlerë të huave raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanc. Kur vendoset që një hua nuk mund të rekuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat.
- për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjione dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- për aktivet financiare të vlefshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën e tregut e një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në kapital dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të ketë rënie në vlerë, humbja e akumuluar që është njohur direkt në kapital do të hiqet nga kapitali dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar zotërohet përsëri nga Banka.

## 2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

### (f) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë blerë nën marrëveshje për t'i rishitur (marrëveshje riblerjeje e anasjelltë) dhe letrat me vlerë shitur nën marrëveshje për t'i riblerë (marrëveshjet e riblerjes) janë trajtuar përgjithësisht si hua të kolaterizuara dhe rregjistrohen me shumën e parave të dhëna/marra, plus interesin e përllogaritur.
Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i duhet të krijojë kolateral për këto letra me vlerë.
Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikqyrës të Bankës.

### (g) Aktive të qëndrueshme

Aktivet e qëndrueshme shprehen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar, me përjashtim të ndërtesave të Bankës, te cilat shprehen të rivlerësuara me metodën e kostos së zëvendësimit (Shënimi 11). Çdo rritje që rrjedh nga rivlerësimi i godinave kreditohet direkt në kapital në zërin rezerva të rivlerësimit të ndërtesave, përveç rastit kur kjo rritje anullon rënien nga vlerësimi i të njëjtit aktiv, të njohur më përpara në fitim/humbje, rast ky specifik ku rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim/humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht. Çdo rënie në vlerën e mbetur të ndërtesave, rezultuar nga procesi i rivlerësimit njihet direkt fitim/humbje deri në masën e balancës së njohur në rezervat e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i godinave.

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme përcaktohen si diferencë midis vleres neto të daljes nga bilanci dhe vlerës neto kontabël te mjetit dhe regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet fikse bazuar në koston historike ose shumën e rivlerësuar. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivit. Jetëgjatësia e zbatuar në vitin 2007 është e njëjtë me atë të vitit 2006:

| | **2007** |
|---|---|
| Ndërtesa–godina qëndrore | 40 vjet |
| Ndërtesat–në degë | 25 vjet |
| Mjete transporti | 5–10 vjet |
| Pajisje zyre | 3–20 vjet |
| Programe kompjuteri | 2 vjet |

## 2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (vazhdim)

### (h) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parasë

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

### (i) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" dhe bazuar në këtë ligj i gjithe fitimi kalon direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

### (j) Rezerva e Përgjithshme

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Banka ka krijuar një rezervë të përgjithshme në të cilën transferohet 25 % e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500 % të fondit të themelimit.

### (k) Grantet

Grantet regjistrohen fillimisht në bilanc me shumën e marrë. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen më blerjen e pronave, paisjeve dhe programeve kompjuterike kalohen te pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve përgjatë jetës së aktivit përkatës në shumën që i përket zhvlerësimit/amortizimit që i zbritet aktivit.

### (l) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhjes së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj ndahen në arka në LEKË dhe në monedha të huaja, si dhe depozita në monedhë të huaj me maturitet të mbetur më pak se tre muaj.

### (m) Përdorimi i parashikimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëje parashikime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente, llogaritur në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhave të raportuara. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

### (n) Ndryshime në politikat kontabël

Në vitet e mëparshme banka e ka njohur vlerën e godinave të saj, përjashto godinën qëndrore, me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar. Gjate vitit që mbyllet më 31 Dhjetor 2007 banka ka përfunduar procesin e rivleresimit për të gjithë kategorinë e ndërtesave dhe ka ndryshuar politikën e njohjes kontabël nga metoda e kostos historike në modelin e rivleresimit.
Amortizimi i akumuluar në datën e rivleresimit është hequr kundrejt kostos historike të ndërtesave dhe vlera neto është shprehur si vlera e rivleresuar e ndërtesave.

## 3. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 Dhjetor 2007, vlera e arit të vendosur në depozita, mjete të Bankës ishte 923 milionë LEKË (2006 – 797 milionë LEKË) e cila përbëhet prej 13,319 onz në shufra prej ari (2006 – 13,319 onz ar).
Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferenca prej 126 milionë LEKË (2006- 89 milionë LEKË), rezulton nga rivlerësimi i arit është regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 Dhjetor 2007, një onz ar u vlerësua me 836.5 USD (2006 –635.7 USD).

Ari dhe metale të tjera të çmuara të përfshira në aktive në monedhë vendase përfshin gjendjet e platinit dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit, me një shumë totale prej 57 milionë LEKË më 31 Dhjetor 2007 (2006 – 48 milionë LEKË), si edhe ar jo monetar prej 6 milionë LEKË (2006 – 5 milionë LEKË).

## 4. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---:|---:|
| Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) | 6,868 | 7,012 |
| E drejta speciale e tërheqjes (“SDR”) | 160 | 847 |
| Interes i përllogaritur | 3 | 8 |
| **Totali** | **7,031** | **7,867** |

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar (“FMN”) rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë pranë FMN-së, në përputhje me Ligjin Nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”Këto depozita kanë si kundërparti huatë e dhëna nga FMN për Republikën e Shqipërisë siç paraqitet në shënimin 12.
E drejta speciale e tërheqjes përfaqëson depozitat e vendosura pranë FMN-së. Këto depozita kanë një interes të përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 Dhjetor 2007 ishte 3.5 % (2006 – 4.07 %).

## 5. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Llogari rrjedhëse | 9,472 | 17,281 |
| Depozita afatshkurtra | 31,369 | 20,803 |
| Interes i përllogaritur | 135 | 73 |
| **Totali** | **40,976** | **38,157** |

Depozitat afatshkurtër dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja kanë norma interesi që bazohen në monedhën e depozitës apo llogarisë rrjedhëse dhe variojnë nga 0.66 % deri në 6.63 % (2006 – nga 0.17 % deri në 5.29 %).

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja janë në EURO, USD , GBP dhe JPY, të cilat sipas çdo monedhe të huaj u përgjigjen gjëndjeve të mëposhtme:

| | 31 Dhjetor 2007<br>*(në milionë)* | 31 Dhjetor 2006<br>*(në milionë)* |
|---|---|---|
| EURO | 226 | 197 |
| USD | 100 | 96 |
| GBP | 9 | 7 |
| JPY | 4,897 | 4,022 |

## 6. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË TË HUAJ)

### 6.1. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje paraqitur në vlerë tregu është si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Nota thesari të Qeverive të huaja | 89,821 | 87,190 |
| Investime afatmesme të Bank for International Settlements | 26,448 | 18,212 |
| Investime me kurs fiks të Bank for International Settlements (FIX BIS) | 6,432 | 9,711 |
| Bono thesari të Qeverisë Franceze | - | 1,818 |
| Nota thesari të agjensive amerikane | 1,395 | 473 |
| **Totali** | **124,096** | **117,404** |

## 6. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË TË HUAJ) (vazhdim)

### 6.1 INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (vazhdim)

Nota thesarit të Qeverive të huaja përfshijnë nota thesari të Qeverisë Amerikane të shprehura në USD, të Qeverive Franceze dhe Gjermane të shprehura në EURO si dhe të Qeverisë Angleze të shprehura në GBP. Notat e thesarit të qeverive të huaja kanë kurse kuponash që variojnë nga 2.05% në 9 %. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore (USD) dhe vjetore (EURO dhe GBP) si dhe maturimet variojnë nga Prill i vitit 2008 në Tetor të vitit 2016. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.95 % në 5.8 % (2006 – 2.8 % në 5.66 %).

Investimet afatmesme të Bank for International Settlements përbëhen nga letra me vlerë me kupona fikse, të përcaktuara në USD, EURO dhe GBP me kurse që variojnë nga 2.5 % në 4.7 %. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore për investimet në EURO dhe gjashtëmujore për investimet në USD dhe në GBP dhe maturimet variojnë midis Mars 2008 dhe Mars të vitit 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 3.30 % në 5.95 % (2006 –2.87 % në 5.28 %).

Investimet me kurs fiks të Bank for International Settlements (FIX BIS) janë të shprehura në EURO dhe JPY me normë të brendshme kthimi qe variojne nga 0.32 % në 4.39 % (2006 –3.56 % në 5.3 %) dhe me kufij maturiteti nga Janar 2008 në Korrik 2008.

Notat e agjensive amerikane janë të shprehura në USD me kurse kuponi nga 3.25 % deri ne 7.12 %. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë nga Shkurt 2009 deri në Nentor 2011. Norma e brendshme te kthimit variojne nga 4.24 % ne 5.20 % (2006 – 2.4 %).

Portofoli i letrave me vlerë në monedha të huaja, klasifikuar si “të vlefshme për shitje”, paraqitur në vlerë nominale sipas monedhave është si më poshtë:

| | **31 Dhjetor 2007** | **31 Dhjetor 2006** |
|---|---|---|
| **USD** | | |
| Nota të Qeverisë Amerikane | 382 | 388 |
| Investime afatmesme të BIS | 72 | 32 |
| Nota të agjencive amerikane | 16 | 5 |
| Investime me kurs fiks (FIX BIS) | - | 2 |
| **Totali** | **470** | **427** |
| **EURO** | | |
| Nota të Qeverisë Franceze | 87 | 199 |
| Nota të Qeverisë Gjermane | 326 | 169 |
| Investime afatmesme të BIS | 147 | 112 |
| Bono thesari të Qeverisë Franceze | - | 15 |
| Investime me kurs fiks (FIX BIS) | 10 | 60 |
| **Totali** | **570** | **555** |
| **GBP** | | |
| Nota të Qeverisë Angleze | 34 | 27 |
| Investime afatmesme të BIS | 15 | 7 |
| Investime me kurs fiks (FIX BIS) | - | 11 |
| **Totali** | **49** | **45** |
| **JPY** | | |
| Investime me kurs fiks (FIX BIS) | 7,000 | - |
| **Totali** | **7,000** | **-** |

## 6. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (NË MONEDHË TË HUAJ) (vazhdim)

### 6.2. LETRA ME VLERË TË MBAJTURA PËR TREGTIM

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, klasifikuar si "Të mbajtura për tregëtim" paraqitet me vlerë tregu në LEKË si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Nota thesari të Qeverisë Amerikane | 5,818 | 6,407 |
| Nota thesari të agjencive amerikane dhe korporatave | 2,929 | 3,229 |
| **Totali** | **8,747** | **9,636** |

Notat e Qeverisë Amerikane, të shprehura në USD, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 3.37 % dhe 6 % . Interesi është i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe maturiteti varion ndërmjet dhjetorit 2008 dhe gushtit 2012.

Notat e Agjensive Amerikane dhe korporatave, të shprehura në USD, kanë kurse kuponi që variojnë ndërmjet 4.12 % dhe 5,37 %. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore ose gjashtëmujor dhe maturiteti varion ndërmjet Tetor 2008 dhe Nëntor 2010.

Duke filluar nga data 25 korrik 2006, ky portofol administrohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në kuadrin e marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore "Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë" e lidhur me datë 23 shtator 2005. Ky portofol njihet në pasqyrat financiare në datën e tregtimit.

## 7. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ)

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| **Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare** | | |
| Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) | 353 | 358 |
| Agjensia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) | 12 | 12 |
| Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA) | 6 | 6 |
| Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) | 61 | 69 |
| Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) | 48 | 55 |
| Banka Islamike e Zhvillimit (IDB) | 19 | 22 |
| **Totali i kuotizacione** | **498** | **522** |
| Arka në valutë | 4 | 15 |
| Të drejta ndaj IBRD | 250 | 189 |
| **Totali aktive të tjera në monedhë të huaj** | **752** | **726** |

## 7. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË TË HUAJ) (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2007, aktive të tjera në monedhë të huaj përbëhen nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare financiare prej 498 milionë LEKË (2006 – 522 milionë LEKË), si dhe nga arka në valutë me një vlerë prej 4 milionë LEKË (2006 – 15 milionë LEKË).

Kuotizacionet e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në shumën prej 353 milionë Lekë (USD 3.6 milionë), lidhen me shumën e kuotave të paguar tek ky institucion ndërkombëtar. Më 31 Dhjetor 2007 shuma e kuotave të papaguara tek IBRD-ja është 8,001 milionë Lekë ( USD 96.5 milionë) pronësia e të cilave është akoma duke u diskutuar ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë. Të dyja palët janë aktualisht duke negociuar një memorandum për kuptimin e ndarjes të kontributeve origjinale dhe pronësisë së kuotave të zotëruara tek Institucionet Financiare Ndërkombëtare ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë se Shqipërisë

Të drejta ndaj IBRD përfaqëson shumën për t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë nga aktiviteti i administruar nga IBRD, gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes së transaksionit (shiko Shënimin 6.2).

## 8. KREDI PËR PALËT E TRETA

### 8.1. KREDI TRANZITE

Totali prej 95 milionë LEKË (2006 – 139 milionë LEKË) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo–Shqiptare për t'iu shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare (shiko Shënimin 13). Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

### 8.2 KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kredia ndaj bankave vendase përfaqëson marrëveshje të anasjellta riblerjeje të vendosura midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë në vlerën 1,509 milionë LEKË (2006 - 8,904 milionë LEKË ), me afat maturimi njëjavore. Në 31 dhjetor 2007, normat e interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes eshte 6.25 % (2006: 5.6% and 6.51%)

## 9. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (NË MONEDHË VENDASE)

| | **31 Dhjetor 2007** | **31 Dhjetor 2006** |
|---|---|---|
| Bono thesari afatshkurtër të Qeverisë Shqiptare | 66,523 | 67,575 |
| **Totali** | **66,523** | **67,575** |

Më 31 Dhjetor 2007, bonot e thesarit afatshkurtra përfaqësojne bono thesari të Qeverisë me kupon zero, me afat maturimi afatshkurter, të cilat maturohen në periudhën Janar - Shtator 2008. Norma e tyre e kthimit në blerje variojnë nga 6 % deri në 7.94 % (2006 –5.4 % deri në 7.1 %).

## 10. LETRA ME VLERE TE QEVERISE PER NE REZERVE

Në datë 31 Dhjetor 2007 Ministria e Financave ka emëtuar një letër me vlerë me vlerë nominale 6,000 milion Lekë, e cila mbart interes norma e të cilës është sa normat e intersit të bonove të thesarit të tre mujorit të fundit me datë maturimit 27 Mars 2008 dhe me "call option" e kushtëzuar me transferimin e Arit nga Qeveria Shqiptare. Ministria ka të drejtën e tërheqjes së letrës me vlerë pasi të ketë përfunduar transferimi i pronësisë së arit nga Qeveria Shqiptare tek Banka e Shqiperisë, sic shpjegohet në Shënimin 37.1.

Ministria e Financave i ka transferuar Bankës letrat me vlerë të sipërpërmendura pasi më 31 Dhjetor totali i kapitalit të paguar dhe detyrimeve të Bankës tejkaloi totalin e mjeteve në shumën 7,118 milionë Lekë. Letrat me vlerë janë emëtuar në bazë të Nenit 7, të Ligjit "Per Banken e Shqiperise" numër 8269, datë 23 Dhjetor 1997, me qëllim mbulimin e deficitit të përmendur më lart.

## 11. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---:|---:|
| Aktive fikse, neto | 2,263 | 3,123 |
| Aktive të patrupëzuara, neto | 111 | 166 |
| Kredi punonjësve | 1,037 | 857 |
| Debitorë të tjerë | 3 | 6 |
| Numizmatika | 40 | 39 |
| Inventari | 38 | 25 |
| Të tjera | 11 | 7 |
| **Totali** | **3,503** | **4,223** |

Në 31 Dhjetor 2007 Banka ka përfshirë një vlerësues të pavarur në procesin e rivlerësimit të të gjitha ndërtesave të Bankës së Shqipërisë, të përfshirë nën kategorinë "Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme". Metoda e rivlerësimit është ajo e kostos së zëvendësimit, në shumën prej 1,938 milionë LEKË, nga vlera neto kontabël e ndërtesës kryesore prej 1,179 milionë Lekë. Efekti në rritje nga rivlerësimi i ndërtesave te Bankes se Shqiperise në shumën prej 826 milion Lekë u kreditua direkt në llogarinë e Rezervës së Rivlerësimit në kapital, ndërsa efekti ne rënie nga rivleresimi i aktivit prej 69 milionë LEKËsh u rregjistrua në zërin "Shpenzime te përgjithshme të bankës.
Në vitin e mëparshëm, efektivisht me 26 Dhjetor 2006 u krye rivlerësimi i godinës qendrore nga një vlerësues i pavarur bazuar në kapitalizmin e të ardhurave nga qeratë dhe të cmimeve të shitjes të qendrave të reja të bisnezit rreth bankës, e cila krijoi nje efekt në rritje të rezervës së rivlerësimit në shumën 1,706 milion Lekë. Aktivet e qëndrueshme te trupezuara (ndërtesat) janë rivlerësuar sipas metodikës së vlerësimit të kostos së zevendësimit duke respektuar edhe rekomandimin e auditorit të pavarur e kërkesat e SNK 16 "Pasuria, Ndërtesat dhe Paisjet" Sistemimi i këtij transaksioni është rregjistruar në pasqyrat financiare të Bankës për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2007.
Në 31 Dhjetor 2007 kreditë e punonjësve perfshijne provigjione për cështje gjyqësore që lidhen me to, në masën 10 milionë LEKË.

Në 31 Dhjetor 2007, vlera e rregjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës arrin në shumën 1,218 milionë LEKË (2006: 990 milionë LEKË).

## 11. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE) (vazhdim)

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

| | Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme | Pajisje të përgjithshme | Mjete transporti | Ndërtime ne proces | Totali i aktiveve fikse |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kosto/Vlerësimi** | | | | | |
| Gjëndja më 1 Janar 2007 | 2,964 | 710 | 200 | 33 | 3,907 |
| Shtesat | 6 | 121 | 41 | 39 | 207 |
| Pakesime | - | (53) | - | - | (53) |
| Transferime | 24 | - | - | (24) | - |
| Sistemim i rivleresimit te godinës 2006 | (1,706) | - | - | - | (1,706) |
| Sistemim i eliminimit te rivleresimit 2006 | 189 | - | - | - | 189 |
| Rivleresimi i ndertesave te Bankes | 758 | - | - | - | 758 |
| Eliminim në rivlerësim | (293) | - | - | - | (293) |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2007** | **1,942** | **778** | **241** | **48** | **3,009** |
| **Amortizimi i akumuluar** | | | | | |
| Gjëndja më 1 Janar 2007 | 69 | 560 | 155 | - | 784 |
| Amortizimi i vitit | 35 | 67 | 15 | - | 117 |
| Pakesime | - | (51) | - | - | (51) |
| Sistemim i eliminimit te rivleresimit 2006 | 189 | - | - | - | 189 |
| Eliminim në rivlerësim | (293) | - | - | - | (293) |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2007** | **-** | **576** | **170** | **-** | **746** |
| **Vlera kontabël neto** | | | | | |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2007** | **1,942** | **202** | **71** | **48** | **2,263** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2006** | **2,895** | **150** | **45** | **33** | **3,123** |

## 11. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE) (vazhdim)

Vlera neto kontabël e aktiveve fikse të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

| | Programe kompjuterike | Bankënota të prera dhe monedha të shtypura | Totali i aktiveve fikse të patrupëzuara |
|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | |
| Gjendja më 1 Janar 2007 | **338** | **2,454** | **2,792** |
| Shtesat | 15 | - | 15 |
| Pakesime | | (1) | (1) |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2007** | **353** | **2,453** | **2,806** |
| **Amortizimi i akumuluar** | | | |
| Gjendja më 1 Janar 2007 | **314** | **2,312** | **2,626** |
| Amortizimi i vitit | 24 | 45 | 69 |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2007** | **338** | **2,357** | **2,695** |
| **Vlera kontabël neto:** | | | |
| **Më 31 Dhjetor 2007** | **15** | **96** | **111** |
| **Më 31 Dhjetor 2006** | **24** | **142** | **166** |

## 12. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit (PRGF) | 6,821 | 8,364 |
| Llogaria e letrave me vlerë tek Fondi Monetar Ndërkombëtar | 5,042 | 4,812 |
| Llogari e FMN-së në LEKË | 2,077 | 2,077 |
| Interes i përllogaritur | 6 | 3 |
| **Totali** | **13,946** | **15,256** |

Huatë PRGF jane të lidhura me kuotizacionet për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Keto hua perfshijne programet e mëposhtme:

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 2” u miratua me marrëveshjen e datës 13 Maj 1998 në shumën 45,040,000 SDR, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjëndja më 31 Dhjetor 2007 është 19,660,900 SDR (2006 – 28,668,900 SDR). Kjo është një hua me maturitet e kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 këste gjashtë mujore duke filluar nga viti 2004. Norma e interesit është 0.5 % dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

“Huaja e Uljes se varferise dhe Zhvillimit PRGF 3” u miratua me marrëveshjen e datës 21 Qershor 2002 në shumën 28,000,000 SDR dhe është disbursuar deri më 20 Qershor 2005. Gjëndja në fund të vitit 2007 është 27,600,000 SDR (2006 - 28,000,0000 SDR) me një interes prej 0.5 % i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysëm, me 10 këste të barabarta.

“Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit” (PRGF 4) dhe “Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EEF) u miratuan me marrëveshjen trevjecare të datës 27 Janar 2006 në shumën 17,045,000 SDR.

Disbursimi i dy transheve të dytë të PRGF 4 prej 2,435,000 SDR u bë në vitin 2007, me nje interes prej 0.5 % i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe gjendja me 31 dhjetor 2007 eshte 4,870,000 SDR. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, në dhjetë këste gjashtë mujore të barabarta.

“Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm” EFF e disbursuar prej 4,870,000 SDR gjatë viteve 2006-2007 është vlerësuar 690 milionë LEKË. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas katër vjet e gjysmë, brenda 10 vjeteve. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 Dhjetor 2007 interesi ishte 4.77 %.

## 13. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JO REZIDENTE

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Detyrime tranzite (Shënimi 8.1) | 95 | 139 |
| Hua e Republikes së Greqisë | 1,072 | 1,090 |
| Detyrime ndaj Bankës Botërore | 12 | 12 |
| Interes I përllogaritur | 4 | 5 |
| **Totali** | **1,183** | **1,246** |

Detyrime tranzite prej 95 milionë LEKË përfaqëson huanë e dhënë nga Banka Europiane e Investimeve dhe përbëhet nga huaja prej 0.8 milionë EURO (shënimi 8.1). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (Bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek siguruesit e financimit.

Huaja e Republikës Greke prej 8.8 milionë EURO është dhënë me qëllim financimin e bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind, e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga llogaritë e organizatave ndërkombëtare pranë Bankës së Shqipërisë, si Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Agjensia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), Agjensia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), Korporata Financiare Nderkombetare (IFC).

## 14. PARAJA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 Dhjetor 2007 dhe 2006 shuma e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2007 | | 31 Dhjetor 2006 | |
|---|---|---|---|---|
| **Vlera Nominale LEKË** | **Copë (në mijë)** | **Totali LEKË (milionë)** | **Copë (në mijë)** | **Totali LEKË (milionë)** |
| 100 | 5,906 | 591 | 9,244 | 924 |
| 200 | 13,183 | 2,637 | 15,799 | 3,160 |
| 500 | 52,883 | 26,441 | 66,541 | 33,271 |
| 1,000 | 69,202 | 69,202 | 72,601 | 72,601 |
| 5,000 | 12,074 | 60,368 | 11,351 | 56,755 |
| Monedha | | 1,923 | | 1,523 |
| | | **161,162** | | **168,234** |

## 15. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| **Në monedha të huaja** | | |
| Rezerva e detyrueshme | 23,848 | 18,273 |
| Llogari të bankave të nivelit të dytë | 1,964 | 67 |
| | **25,812** | **18,340** |
| **Në monedhë vendase** | | |
| Rezerva e detyrueshme | 32,837 | 30,122 |
| Llogari të bankave të nivelit të dytë | 3,148 | 453 |
| Marrëveshjet e riblerjes | - | 4,199 |
| Depozita njëditore | 5,211 | 436 |
| | **41,196** | **35,210** |
| Interes i përllogaritur | 43 | 25 |
| **Totali** | **67,051** | **53,575** |

Interes mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjëndjet në LEKË: 70 % e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 4.375 % më 31 Dhjetor 2007 (70 % e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 3.85 % më 31 Dhjetor 2006);
- gjëndjet në USD: 70 % e normës së USD libor njëmujore: 3.40 % më 31 Dhjetor 2007 (70 % e normës së USD libor njëmujore: 3.75 % më 31 Dhjetor 2006);
- gjëndjet në EURO: 70 % e normës së EURO libor njëmujore: 3.11 % më 31 Dhjetor 2007 (70 % e normës së EURO libor njëmujore: 2.57 % më 31 Dhjetor 2006).

Depozitat me afat njëditor kanë normë interesi prej 4.5 % (2006 – 3.75 %).

## 16. DETYRIMI NDAJ QEVERISË

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Fitim për t'iu shpërndarë qeverisë | - | - |
| Depozita në emër të qeverisë | 14,280 | 15,922 |
| Të tjera | 33 | 22 |
| **Totali** | **14,313** | **15,944** |

Depozita në emër të qeverisë prej 14,280 milionë LEKË, përfshin llogarinë kryesore prej 7,622 milionë LEKË, fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri prej 2,790 milionë LEKË, fonde rezervë të qeverisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) prej 1,348 milionë LEKË, si dhe fonde të tjera me destinacion për financime prej 2,520 milionë lekësh.

Zëri "Të tjera" përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit prej 19 milionë LEKË (2006 – 22 milionë LEKË) dhe tatimi mbi interesat e bonove te thesarit prej 14 milionë LEKË .

## 17. TË ARDHURA PËR T'U SHPËRNDARË

| | Ndihma nga Banka Boterore | Te tjera | Total |
|---|---|---|---|
| Gjëndja më 31 Dhjetor, 2006 | 132 | 36 | 168 |
| Pakësime | (64) | (36) | (100) |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2007** | **68** | **-** | **68** |
| **Amortizimi i akumuluar** | | | |
| Gjëndja më 31 Dhjetor, 2006 | 92 | - | 92 |
| Amortizimi i vitit | 37 | - | 37 |
| Pakësime | (64) | - | (64) |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor 2007** | **65** | **-** | **65** |
| **Vlera neto kontabël** | | | |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor,2007** | **3** | **-** | **3** |
| **Gjëndja më 31 Dhjetor,2006** | **40** | **36** | **76** |

Ndihma nga Banka Botërore i referohet ndihmave të përfituara nga Banka gjatë viteve 2002-2005, respektivisht per blerjen e programeve kompjuterike dhe paisjeve për zbatimin e projektit AIPS "Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare" prej 68 milionë LEKË. Pakësimi në zërin Ndihma nga Banka Botërore rezulton nga amortizimi i plotë i ndihmës dhënë nga Banka Botërore për blerjen e projektit AECH "Sistemi i Kryqëzimit të Pagesave me vlerë të vogël" prej 64 milionë LEKË.

"Të tjera" prej 36 milionë LEKË përfaqëson vlerën e dy godinave dhuratë në qytetet Korçë dhe Berat. Banka në 31 Dhjetor 2007 njohu si të ardhur të periudhës të gjithë shumën e mëparshme të granteve.

## 18. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Detyrimi ndaj Shtypshkronjës (Shënimi 30) | 215 | 233 |
| Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari | 586 | 636 |
| Detyrimi ndaj fondit të pensionit, neto | 6 | 6 |
| Të tjera | 120 | 79 |
| **Totali** | **927** | **954** |

Skema e fondit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve në vlerën 2 % te pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit 15 % mbi totalin e pagave. Në 31 dhjetor 2007, vlera e mjeteve të fondit të pensionit e investuar në letra me vlerë të qeverisë me afat maturimi 12 mujor, është 391 milionë LEKË dhe me afat maturimi 5 vjeçar është 69 milionë LEKË. Vlera e akumuluar e kontributeve të derdhura nga punonjësit e sigurur në fond deri në 31 Dhjetor 2007 është 36 milionë LEKË (31 Dhjetor 2006 - 24 milionë LEKË), ndërkohë që totali i kontributeve të derdhura nga Banka në Fond që nga krijimi i Fondit deri në 31 Dhjetor 2007 është në vlerën 298 milionë LEKË (31 Dhjetor 2006 – 251 milionë LEKË).

Në zërin "Të tjera", përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 54 milionë LEKË (2006 – 29 milionë LEKË), të cilat lidhen me mirëmbajtjen e sistemit ATM, sherbime për informacione statistikore, komisione për manaxhimin e rezervës valutore nga IBRD, etj. Në këtë zë është përfshirë edhe provigjionimi i pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Në 31 Dhjetor 2007, një provigjion prej 20 milionë LEKË është njohur në lidhje me këto pretendime (2006 – 22 milionë LEKË). Gjatë vitit 2007 rezulton një shtesë në provigjione prej 8 milionë LEKË dhe janë rimarrë në të ardhura 6 milionë LEKË nga provigjionet i viteve të kaluara (shënimi 27).

## 19. FONDI I THEMELIMIT

Në bazë të shkresës së Ministrise se Financave nr 9852 datë 28 Dhjetor 2007 dhe bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4, date 23 Janar 2008 fondi i themelimit u rrit me 1,750 milionë LEKË.

## 20. REZERVA E PËRGJITHSHME

Me rritjen e fondit të themelimit, në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", në fund të cdo viti financiar Banka duhet të shtojë fondin e rezervës së përgjithshme me një shumë prej 25% të fitimit neto të Bankës, deri sa të arrijë 500% të fondit të themelimit të Bankës.
Vendimi për rritjen e kapitalit është marrë në 28 Dhjetor 2007, dhe për këtë qëllim banka nuk arriti të transferojë në fondin e rezervës së përgjithshme në masën 25 % të fitimit neto, por transferoi vetëm shumën prej 1,431 milionë LEKË.

## 21. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit | (23,540) | (15,505) |
| Rivleresimi i letrave me vlerë | 747 | (377) |
| Rivlerësime të tjera | 34 | 26 |
| **Totali** | **(22,759)** | **(15,856)** |

Gjatë vitit 2007, humbja neto nga rivlerësimi i monedhave të huaja dhe arit nga luhatja e kursit të këmbimit është në një vlerë prej 8,035 milionë LEKË (gjatë vitit 2006 – humbja neto 3,341 milionë LEKË).

Rivlerësimi i letrave me vlerë me vleren e tregut, gjatë vitit 2007 ka luhatje positive prej 1,124 milionë lekësh.

Në perputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" neni 64, pika (a), fitim/humbja neto e rezultuar nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve në valutë të huaj, transferohet ne kapital në një llogari rivlerësimi "Rezerva të rivlerësimit nga kursi i këmbimit".

Në vijim të po këtij neni, pika (b), gjatë vitit 2007 Ministria e Financave ka riemetuar letra me vlerë të qeverisë me një total prej 15,505 milionë LEKË për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave, krijuar deri në fund të vitit 2006. Këto letra me vlerë mbahen në llogari jashtë bilancit, me një maturitet të rinovueshëm prej gjashtë muajsh. Totali prej 15,505 milionë lekësh përfaqëson mbulimin e humbjeve për periudhen 2003 deri ne 2006.

## 22. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Rezervë speciale për Bilancin e Pagesave | 7,209 | 7,209 |
| Fonde nga qeveria për mbulimin e përkohshëm të mungesës së kapitalit (shënimi 10) | 5,908 | - |
| Fondi i investimit | 301 | 301 |
| Të tjera | 1,196 | 1,196 |
| **Totali** | **14,614** | **8,706** |

Rezerva speciale për Bilancin e Pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Europian për Shqipërinë si asistencë financiare për të mbështetur Shqipërinë në procesin e transformimit të ekonomisë në një ekonomi tregu. Këto grante i përkasin periudhës 1992 – 1993, në mbeshtetje të qëndrueshmërisë së bilancit të pagesave si dhe për të forcuar pozicionin e rezervave. Kjo rezervë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 1995.

Fondi i investimit përbehet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

"Të tjera" përfshin rezerva të krijuara në vitet respektive me vendim të Këshillit Mbikqyrës, nga shpërndarja e fitimit gjatë viteve 2002-2006.

## 23. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (JO-REZIDENTËT)

| | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë | 5,436 | 4,811 |
| Interesa nga depozitat me afat | 1,145 | 684 |
| Interesa nga depozitat ne SDR me FMN | 33 | 51 |
| Të tjera (skonto) | 537 | 324 |
| **Totali** | **7,151** | **5,870** |

## 24. SHPENZIME PËR INTERESA DHE KOMISIONE (JO-REZIDENTËT)

| | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Amortizimi i primit të letrave me vlerë | 222 | 406 |
| Shpenzime për interesa nga huatë e institucioneve të huaja | 13 | 13 |
| Shpenzime për interesa nga llogaritë e FMN | 69 | 59 |
| Të tjera | 33 | 16 |
| **Totali** | **337** | **494** |

## 25. TË ARDHURA NGA INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

| | Viti që perfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë | 4,362 | 3,902 |
| Interesa nga huatë qeveritare | 6 | 6 |
| Te ardhura nga interesat e marreveshjeve te anasjellta te riblerjes | 227 | 55 |
| Të tjera | 38 | 57 |
| **Totali** | **4,633** | **4,020** |

## 26. SHPENZIME PER INTERESA DHE KOMISIONE (REZIDENTËT)

| | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Shpenzime për interesa mbi rezervën e detyrueshme | 1,915 | 1,440 |
| Shpenzime për interesa mbi marrëveshjet REPO | 140 | 233 |
| Shpenzime per interesa mbi depozitat e qeverise | 184 | - |
| Të tjera | 63 | 58 |
| **Totali** | **2,302** | **1,731** |

## 27. TË ARDHURA / (SHPENZIME ) TË TJERA OPERATIVE, NETO

| | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti që përfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Humbje neto nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje | (114) | (1,503) |
| Fitim neto nga shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim | 41 | 72 |
| Amortizimi i grantit dhe ndihma (shënimi 17) | 73 | 53 |
| Provigjione për çështje ligjore dhe të tjera (Shënimi 18) | (8) | (25) |
| Të tjera (shënimi 11 dhe 18) | 38 | 32 |
| Fitim i parealizuar nga rivlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për tregtim | 215 | 4 |
| Fitim neto nga kontratat forward | 41 | - |
| **Totali** | **286** | **(1,367)** |

## 28. SHPENZIME TË PERSONELIT

Shpenzime të personelit përfshijnë pagat e personelit, kontributet për sigurimet shoqërore, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

Shpenzimet sociale përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Institutit te Sigurimeve Shoqërore. Më 31 Dhjetor 2007, Banka ka patur 391 punonjës (2006 – 378 punonjës).

## 29. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| Depozita në Bankat e huaja (Shënimi 5) | 40,841 | 38,084 |
| Likuiditete në monedhë vendase | 11,338 | 7,765 |
| Likuiditete në monedhë të huaj (Shënimi 7) | 4 | 15 |
| Ari i mbajtur jashtë vendit (Shënimi 3) | 923 | 797 |
| Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend (Shënimi 3) | 63 | 53 |
| **Totali** | **53,169** | **46,714** |

## 30. SHTYPSHKRONJA

Sic është detajuar në shënimin 2(a), Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 598, datë 5 Shtator 2007, aktiviteti ekonomik dhe financiar i shtypshkronjës do të mbyllet me 31 Mars 2008.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 Dhjetor 2007 dhe 2006 paraqitet si më poshtë:

| | **31 Dhjetor 2007** | **31 Dhjetor 2006** |
|---|---|---|
| **AKTIVET** | | |
| Aktive të qëndrueshme të trupëzuara | 6 | 11 |
| Inventari | 49 | 25 |
| Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 18) | 215 | 233 |
| **Totali i aktiveve** | **270** | **269** |
| **KAPITALI I VET** | | |
| Kapitali themeltar | 51 | 51 |
| Rezerva ligjore | 19 | 19 |
| Rezerva e investimit | 24 | 24 |
| Rezerva të tjera | 6 | 6 |
| Fitimi i mbartur | 169 | 168 |
| **Totali i kapitalit të vet** | **269** | **268** |
| Detyrime të tjera | 1 | 1 |
| **Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve** | **270** | **269** |

| | **Viti që përfundon më 31 Dhjetor 2007** | **Viti që përfundon më 31 Dhjetor 2006** |
|---|---|---|
| Të ardhura | 52 | 72 |
| Shpenzime | (51) | (65) |
| **Fitimi i vitit** | **1** | **7** |

## 31. ANGAZHIME DHE GARANCI

Banka mban disa llogari në monedhë të huaj, në lidhje me marrëveshjet e lidhura midis Qeverisë së Shqipërisë dhe qeverive ose organizatave financiare të huaja. Meqë këto llogari nuk përbëjnë as aktiv as detyrim për Bankën e Shqipërisë, ato nuk janë përfshirë në bilancin e Bankës.

Në 31 Dhjetor 2007, letra me vlerë emetuar nga Ministria e Financave për mbulimin e humbjeve neto nga rivlerësimi i monedhave të krijuara në periudhën 2003-2006 rezulton të jetë 15,505 milionë LEKË, me terma maturimi të rinovueshëm çdo gjashtë muaj.

## 32. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 Dhjetor 2007, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra me vlerë nominale 246 miliardë LEKË, obligacione me afat nga 2 vjet deri 7 vjet me vlerë nominale 122 miliardë LEKË. Këto instrumente financiare përfaqësojnë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Më 31 Dhjetor 2007, Banka mbante në kujdestari ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të Qeverisë me vlerë tregu prej 6,129 milionë LEKË. Në rolin e kujdestarit për këto aktive, Banka nuk mbart asnjë lloj rreziku krediti.

Më 31 Dhjetor 2007 dhe 2006 vlera e arit në kujdestari në emër të Qeverisë përbëhet si më poshtë :

| | **31 Dhjetor 2007 (në milionë LEKË)** | **31 Dhjetor 2006 (në milionë LEKË)** |
|---|---|---|
| Ar monetar i mbajtur në Bankat e huaja | 2,584 | 2,230 |
| Ar jo monetar i mbajtur në Bankat e huaja | 1,292 | 1,115 |
| Ar jo monetar i mbajtur brenda vendit | 2,041 | 1,761 |
| Metale të tjera të çmuara | 212 | 202 |
| **Totali** | **6,129** | **5,308** |

Interesat e marra nga depozitimi i rezervave të arit të Qeverisë njihen si të ardhura nga interesat për Qeverinë duke rritur detyrimin ndaj tyre. Për vitin 2007 interesat e marra janë rreth 5.5 onz. Diferenca prej 821 million LEKË është rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit. (Shënimi 3)

Këto llogari nuk pasqyrohen në pozicionin financiar të Bankës.

## 33. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhenies dhe jo formës së mirëfilltë ligjore.

Banka e Shqiperisë nuk ka palë të lidhura përveçse marëdhënieve me drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikqyrës. Më 31 Dhjetor 2007 and 31 Dhjetor 2006, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përbëhen nga:

| | 31 Dhjetor 2007 | 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| **Kredi për strehim për stafin** | | |
| - Staf drejtues | 110 | 84 |
| **Totali** | **110** | **84** |

Kreditë kanë norma interesash prej 0.5 % dhe janë të pagueshme në 30 vjet, duke filluar pas një periudhe prej dy vitesh, me këste të barabarta mujore. Këto kredi janë të kolateralizuara.

| | Viti qe perfundon 31 Dhjetor 2007 | Viti qe perfundon 31 Dhjetor 2006 |
|---|---|---|
| **Shpenzime administrative** | | |
| **-Shpenzime Telefoni** | | |
| - Drejtorët dhe Anëtaret e Këshillit Mbikqyrës | 4 | 4 |
| **-Paga dhe Bonuse** | | |
| -Drejtorët dhe Anëtaret e Këshillit Mbikëqyrës | 90 | 78 |
| **-Kontributi i Bankës në skemën e fondit të pensionit** | | |
| -Drejtorët | 7 | 7 |
| **Totali i shpenzimeve administrative** | **101** | **89** |

## 34. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rezerva valutore administrohet nga Banka e Shqipërisë dhe investimi i saj realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare i cili bazohet në rregulloren "Mbi politikën e administrimit të rezervës valutore", e cila miratohet nga Këshilli Mbikqyrës. Rezerva valutore në përputhje me nevojat për likuiditet investohet në instrumenta financiare afatshkurtër dhe letra me vlerë me të ardhura konstante.

### Rreziku i likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomikë. Banka menaxhon rrezikun e likuiditetit nëpërmjet investimit në depozita afatshkurtër me Bankat e huaja.
Politikat e administrimit të likuiditetit vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, Banka të jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj.

### Rreziku i kreditit

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për Bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të Qeverisë.

### Rreziku i çmimeve

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe
- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj janë paraqitur në secilën prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivet që paguajnë interes (siç detajohet në shënimin 35 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative, gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

## 35. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TE MBETUR)

| | Deri në një muaj | Një deri në tre muaj | Tre deri në gjashtë muaj | Gjashtë deri në një vit | Një deri në pesë vjet | Mbi pesë vjet | Jo të ndjeshëm ndaj interesit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | | | | | |
| Ari dhe metalet e çmuara | - | - | - | - | - | - | 923 | 923 |
| Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar | 160 | - | - | - | - | - | 6,871 | 7,031 |
| Depozita në Banka të huaja | 32,961 | 7,880 | - | - | - | - | 135 | 40,976 |
| Investime të vlefshme për shitje | 3,705 | 6,646 | 9,479 | 13,679 | 88,586 | 2,001 | - | 124,096 |
| Investime të mbajtura per tregtim | - | - | - | 659 | 8,088 | - | - | 8,747 |
| Aktive të tjera në monedhë të huaja | 250 | - | - | - | - | - | 502 | 752 |
| Ari dhe metalet e çmuara | - | - | - | - | - | - | 63 | 63 |
| Kredi tranzite | - | - | - | - | - | - | 95 | 95 |
| Kredi ndaj bankave vendase | 1,508 | - | - | - | - | - | 1 | 1,509 |
| Investime të vlefshme për shitje | 26,650 | 19,328 | 19,597 | 948 | - | - | - | 66,523 |
| Leter me vlere e qeverise per mbulim kapitali | | 5,909 | - | - | - | - | - | 5,909 |
| Aktive të tjera vendase | - | - | - | - | - | 1,048 | 2,455 | 3,503 |
| **Totali i Aktiveve** | **65,234** | **39,763** | **29,076** | **15,286** | **96,674** | **3,049** | **11,045** | **260,127** |
| | | | | | | | | |
| **Detyrimet dhe kapitali i vet** | | | | | | | | |
| Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar | 218 | 139 | 347 | 555 | 4,324 | 1,928 | 6,435 | 13,946 |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase | - | - | - | - | - | 1,072 | 111 | 1,183 |
| Detyrime te tjera te huaja | 251 | - | - | - | - | - | - | 251 |
| Paraja në qarkullim | - | - | - | - | - | - | 161,162 | 161,162 |
| Detyrime ndaj bankave vendase | 61,896 | - | - | - | - | - | 5,155 | 67,051 |
| Detyrime ndaj qeverisë | - | - | - | - | - | - | 14,313 | 14,313 |
| Të ardhura për t'u shpërndarë | - | - | - | - | - | - | 3 | 3 |
| Detyrime të tjera vendase | - | - | - | - | - | - | 927 | 927 |
| Kapitali dhe rezervat | - | - | - | - | - | - | 1,291 | 1,291 |
| **Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat** | **62,365** | **139** | **347** | **555** | **4,324** | **3,000** | **189,397** | **260,127** |
| | | | | | | | | |
| **Ndryshimi i bilancit më 31 Dhjetor 2007** | **2,869** | **39,624** | **28,729** | **14,731** | **92,350** | **49** | **(178,352)** | **-** |
| **Ndryshimi i Akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit - 2007** | **2,869** | **42,493** | **71,222** | **85,953** | **178,303** | **178,352** | **-** | **-** |

## 35. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT (ANALIZA E MATURITETIT TË MBETUR) (vazhdim)

| | Deri në një muaj | Një deri në tre muaj | Tre deri në gjashtë muaj | Gjashtë deri në një vit | Një deri në pesë vjet | Mbi pesë vjet | Jo të ndjeshëm ndaj interesit | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | | | | | |
| Ari dhe metalet e çmuara | - | - | - | - | - | - | 797 | 797 |
| Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar | - | 847 | - | - | - | - | 7,020 | 7,867 |
| Depozita në Banka të huaja | 31,866 | 6,218 | - | - | - | - | 73 | 38,157 |
| Investime të vlefshme për shitje | - | 473 | 664 | 23,009 | 90,969 | 2,289 | - | 117,404 |
| Investime të mbajtura per tregtim | - | - | - | 1,253 | 8,383 | - | - | 9,636 |
| Aktive të tjera në monedhë të huaj | 189 | - | - | - | - | - | 537 | 726 |
| Ari dhe metalet e çmuara | - | - | - | - | - | - | 53 | 53 |
| Kredi tranzite | - | - | - | - | - | - | 139 | 139 |
| Kredi ndaj bankave | 3,350 | 5,500 | - | - | - | - | 54 | 8,904 |
| Investime të vlefshme për shitje | 25,013 | 23,932 | 18,630 | - | - | - | - | 67,575 |
